



**SADO QË THEMI: "ALL-LLAHU
EKBER", KA ENDE SHPRESË
PËR NJERËZIMIN!**



**NË KËTË BOTEN TONË
TË ÇORODITUN...**



**H. BUJAR SPAHIU,
KRYETAR I RI I KOMUNITETIT
MYSLIMAN TË SHQIPËRISË**

Viti 17 - Nr. 3 (193),
Mars, 2019

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

ISLAMI NUK JU URREN, ZOTËRI!

Shoqëria e jonë ka nevojë për prekjet begatuese të Islamit që e zbut natyrën
njerëzore, që e bën njeriun, Njeri; i paqtë, paqtues, paqëbërës, dhurues i sigurisë
me sjelljen dhe moralin e tij.

Në mesin e të vdekurve në sulmin terrorist
ndaj dy xhamive gjatë namazit të
xhumasë më 15 mars në Zelandën e
Re, gjenden shumë të arsimuar,
profesionistë si dhe migrantë që
kanë shkuar në vend me
shpresa për të krijuar një të
ardhme të re

**Viktimat e sulmit
ndaj dy xhamive
në Zelandën e Re**

15 mars 2019



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Kalendari i llogarive tona, shënon sot 1 Rexheb 1440. Zyrtarisht kemi hyrë në atmosferën e një muaji, për të cilin All-llahu i Madhëruar thotë në suren Et-Teube: “Tek All-llahu numri i muajve është dymbëdhjetë (sipas hënës), ashtu si është në librin e All-llahut prej ditës kur krijoi qiejt dhe tokën. Prej tyre katër janë të shenjtë. Kjo është fe e drejtë. Pra, mos e ngarkoni (me gjynahe) veten tuaj në këta (katër muaj)...”¹, deri në fund të ajetit.

Ajo që nxit ky ajet, dhe që përbën edhe thelbin e marrëdhënies tonë me këtë muaj të shquar dhe ata që e pasojnë, që në gjuhën popullore i quajmë: “Muaj të Mirë”, është mbi të gjitha distancimi nga zullumi! Po, zullumi, që në gjuhën tonë i thonë: padrejtësi!

Zullumi me veten, kur e humbim kohën dhe nuk e vlerësojmë se ajo është esenca e sekreteve hyjnore, me të cilat na ka begatuar Zoti i gjithësisë, i Cili, sa e sa herë është betuar për të në Kur’anin Famëllartë, që ne të kuptojmë!

Zullumi me fëmijët, që shpesh refuzojmë t’i dëgjojmë, për të shfaqur Krijuesi ynë nëpërmjet fjalëve të tyre prirjet dhe talentet e fshehura, që shpesh i abortojmë, duku u mbyllur gojën, teksa i tregojmë gishtin dëshmues!

Zullumi me familjen, kur në mënyrë të pavetëdijshme, lejojmë që nëpërmjet ca kutive të instaluar nëpër dhomat e ndenjes a duart e skllavëruara para ekraneve të tabloidëve, të na shqyhet pak nga pak perdja e turpër, të na thahet pa e ndjerë uji i fytyrës, të na avullojë në heshtje eliksiri i dritës dhe cilësive të trashëguara, me të cilat qenë veshur të parët, brez pas brezi; ata që jetuan me moral e besim, me fjalë dhe besë,

1. Kur’ani, Et-Teube: 36.

“PRA, MOS E NGARKONI (ME GJYNAHE) VETEN TUAJ NË KËTA (KATËR MUAJ)...”

me dije dhe edukatë, me respekt dhe tolerancë; gjithmonë duke respektuar e shenjtëruar në thelb të zemrës dhe të shpirtit fenë e Zotit dhe kufijtë e saj!

Zullumi me shoqërinë, kur heshtim para padrejtësive të shumta që derdhen në këtë vend, të cilin, një grup i caktuar njerëzish, e konsideron si një kosh të madh, ku duhet hedhur çdo gjë e dëmshme, që shkatërron besimin, vlerat, tabanin, traditat e pastërtisë, nderit e moralit, turpit dhe mendimit, ndërgjegjes besimtare dhe karaktereve të forta që ndërtojnë pa pushim!

Zullumi me tjetrin, kur kemi mundësi ta ndihmojmë e ta qetësojmë me një fjalë të mirë e të urtë, por që shpesh ia kursejmë se, mos na paragjykon!? Kur e kemi mundësinë për ta ndaluar nga një ves a një devijim, por s’e bëjmë dot sepse mund ta humbasim, në një kohë, kur këshilla nuk thuhet, a nuk serviret si duhet, a keqpërdoret, a shitet lirë, a refuzohet plot krenari të ligë e të sëmurë!

Zullumi me tokën tonë, kur harrojmë se prej kemi ardhur e drejt saj do të kthehemi, ndonëse hutohemi e devijojmë në labirinthe e papritura, a edhe rutine, të një jete, që na është dhënë si amanet i shtrenjtë nga Zoti i vetëm i tanësisë, si provë jo e lehtë, si mundësi për të dëshmuar qenien a jo mëkëmbës real të Krijuesit të gjithësisë, i Cili na pajisi me krejt elementët përbërës të suksesit dhe mbarësisë në jetë!

TË DASHURIT E MI,

Në hadithin kudsî, që thaujse të gjithë e kenî lexuar dhe e dëgjoni me vëmendje, All-llahu i Madhëruar na drejtohet duke na thënë: “O robërit e Mi, Unë ia kam ndaluar Vetes padrejtësinë, e bëra atë të ndaluar edhe në mes jush, kështu që mos i bëni njëri-tjetrit padrejtësi! O robërit e Mi! Të gjithë ju jeni në rrugë të gabuar, përveç atij që Unë e udhëzoj, prandaj kërkoni udhëzim nga Unë, që t’ju udhëzoj! O robërit e Mi! Të gjithë ju jeni të uritur, përveç atij që Unë e ushqej, prandaj kërkoni t’ju ushqej, që t’ju ushqej! O robërit e Mi! Të gjithë ju jeni të zhveshur, përveç atij që Unë e vesh, prandaj kërkoni veshje nga Unë, që t’ju vesh! O robërit e Mi! Vërtet ju gaboni natën dhe ditën, kurse Unë i

fal të gjitha gjynahet, prandaj, kërkoni nga Unë falje, që t’ju fal! O robërit e Mi! Ju nuk mund të arrini të më dëmtoni me ndonjë dëm, as që mund të arrini të më sillni ndonjë dobi, që të më bëni të përfitoj! O robërit e Mi! Sikur i pari dhe i fundit nga ju, njerëzit dhe xhinët nga ju, të ishin të përkushtuar, si zemra më e devotshme e njerit nga ju, kjo nuk do të shtonte aspak në sundimin Tim! O robërit e Mi! Sikur i pari dhe i fundit nga ju, njerëzit dhe xhinët nga ju, të ishin të këqij si zemra më e keqe e ndonjërit nga ju, kjo nuk do ta zvogëlonte sundimin Tim në asgjë! O robërit e Mi! Sikur i pari dhe i fundit nga ju, njerëzit dhe

U prish arsimi, u godit institucioni i mësuesit, u shqye perdja e turpit, u godit institucioni i familjes, u godit nana dhe baba, u shit gruaja dhe fëmija, u abuzua me fenë dhe u bë mall në dorën e kujtdo, sado të palara qofshin duart e tij, u godit thelbi, u shënjestrua për vdekje morali dhe e ardhmja e dinjitetit të njerëzimit!

xhinët nga ju, të qëndronit bashkë në një vend dhe të kërkoni nga Unë, do i përgjigjesha lutjes së çdonjërit nga ju dhe, kjo nuk do e pakësonte atë që Unë zotëroj, aq sa do të pakësonte gjilpëra detin nëse do të futej në të! O robërit e Mi! Janë veprat tuaja ato për të cilat do të llogariteni, pastaj Unë do t’ju shpërblej për to! Ai që gjen mirë, le ta falënderojë All-llahun, ndërsa ai që gjen ndryshe nga ajo, mos ta fajësojë askënd përveç vetveten!”²

Ky është thelbi i besimit; ta besosh All-llahun e Madhëruar me krejt cilësitë

2. Transmetuar nga Imam Ahmedi, nga Ebu Dherri El-Gifari (r.a.).

dhe emrat e Tij të plotë e të bukur, duke shpresuar mëshirën dhe bekimet e Tij në jetë! Pa to, asgjë nuk jemi dhe s’mund të jemi! Pa këtë ëmbëlsi të besimit dhe pa vlerat e tij, katandisemi më keq sesa është katandisur bota sot; kudo intriga, pabesi, përçarje, zhvatje të pasurive, korrupsion, krim e shkatërrim, drogë e prostitucion, alkool dhe hipokrizi, dehje pas kësaj bote dhe zhveshje nga përgjegjësitë e jetës, mungesë edukate dhe mosrespekt ndaj shenjtërive, por jo vetëm kaq! E gjithë kjo, në emër të “lirisë absolute”! Jo për këtë jemi krijuar!

U prish arsimi, u godit institucioni i mësuesit, u shqye perdja e turpit, u godit institucioni i familjes, u godit nana dhe baba, u shit gruaja dhe fëmija, u abuzua me fenë dhe u bë mall në dorën e kujtdo, sado të palara qofshin duart e tij, u godit thelbi, u shënjestrua për vdekje morali dhe e ardhmja e dinjitetit të njerëzimit!

Karshi tërë kësaj katrahure, që duket se nuk ka zgjidhje, ne mbetemi këtu ku jemi, si në një përballje të paevitueshme, si para një provimi, nota e të cilit do të jetë vendimtare për cilësinë e të ardhmes!

Provim që na vendos para një dileme të madhe përzgjedhjeje dhe qëndrimi, që përkufizohet në dy ajete kur’anore. I pari: “Mandej do t’ju sillem atyre para, prapa, nga e djathta dhe nga e majta e tyre, e shumicën e tyre nuk do ta gjeshtë të falënderohen (të besojnë)!”.³ I dyti: “O ju që besuat, përgjigjuni (thirrjes së) All-llahut dhe të të dërguarit kur ai (i dërguari) ju fton për atë që ju jep jetë, (për fenë e drejtë) dhe ta dini se All-llahu ndërhyr ndërmyet njeriut dhe zemrës së tij, dhe se ju do të tuboheni tek Ai!”.⁴

A jemi gati ta marrim amanetin dhe t’i përgjigjeni Thirrjes së Jetës, për jetuar me All-llahun, për All-llahun, drejt bekimeve dhe përjetësisë në xhennetet e Tij! All-llahumme amin!

All-llahumme na fal e na mëshiro, na udhëzo e na bëj të qëndrueshëm në këtë fé, na drejto nga dyert e pendimit, që të kërkojmë falje për të shkuarën e të gjejmë qetësi e prehje në të sotmen e të ardhmen, të mbushur me besim e dashuri për Fjalën Tënde dhe të Dërguarin mëshirë për botët! Amin!

(Hytbeja e xhumasë mbajtur në xhaminë e Parrucës, 8 mars 2019)

3. Kur’ani, El-A’rafë: 17.
4. Kur’ani, El-Enfal: 24.

ISLAMI NUK JU URREN, ZOTËRI!

Para disa ditësh ndërroi jetë një burrë i nderuar, që në fjalorin e shoqërisë sonë quhet: “Zotni Shkodre”.

Shpeshherë e kam parë në xhami. Një burrë i qetë, i buzëqeshur, komunikues. Nuk e mbaj mend ndonjëherë jashtë kësaj kornize. Jemi përshëndetur disa herë, me shumë dashamirësi e respekt. Ai me buzëqeshjen e tij, me respektin dhe finesën e zotnillekut të tij, ka lënë gjurmë respekti e nderimi në kujtesën time.

Akoma sot, kujtimi i tij më sjell ndër mend hadithin profetik: “Ata që do të jenë më afër meje në mexhliset e ditës së kiametit, janë ata që kanë sjelljen më të mirë”.

Sepse, në të vërtetë: “Feja është mënyra e sjelljes”! (Dhe unë lutem me zemër që zotnia e tij, me atë buzëqeshje e natyrë të paqte që karakterizohej në botën tonë, të ringjallet në ditën e kiametit)

Pikërisht, ky model esencial i marrëdhënies së muslimanit në shoqëri, është përgjigja më e urtë praktike për krejt ata që frikësohen nga propaganda islamofobe dhe thonë: “Islami na urren!”.

E vërteta është se, shoqëria e jonë ka nevojë për modele frymëzuese të muslimanit-qtetitar, atij që qytetarinë islame e ka në gen dhe di ta shfaqë edhe me heshtjen e tij, edhe me një buzëqeshje-sadeka, edhe me një gjest, edhe me një fjalë...

Realisht, shoqëria e jonë ka nevojë për prekjet begatuese të Islamit që e zbut natyrën njerëzore, që e bën njeriun, Njeri; i paqtë, paqtues, paqëbërës, dhurues i sigurisë me sjelljen dhe moralin e tij.

Shoqëria e jonë ka nevojë për njerëz me fytyra të qeshura, që hyjnë në xhami e dalin prej saj me fytyrë të qeshur, me nur besimi, me shenjat e prehjes, që konvertohen në mirësjellje e mëshirë për krijesat e Zotit në marrëdhëniet e përditshme, mbështetur në udhëzimin muhamedan: “Buzëqeshja në fytyrën e vëllasë tënd është sadeka!”.

Shoqëria e jonë ka nevojë për njerëz me fytyra të qeshura, që hyjnë në xhami e dalin prej saj me fytyrë të qeshur, me nur besimi, me shenjat e prehjes, që konvertohen në mirësjellje e mëshirë për krijesat e Zotit në marrëdhëniet e përditshme, mbështetur në udhëzimin muhamedan: “Buzëqeshja në fytyrën e vëllasë tënd është sadeka!”.

Shoqëria e jonë, përherë e më shumë ka nevojë për modelin e muslimanit, me mirësjelljen e të cilit zbulohen perdet e hirta të paragjykit, dyshimet vrastare që mbushin kokat e njerëzve të zakonshëm, që nuk na kanë as u kemi asnjë borxh, përveç mirësjelljes dhe respektit për shkak të origjinës së përbashkët.

Modeli i zotnive muslimanë me fytyra të qeshura, më kujton shpesh fjalën e Zotnisë së bijve të Ademit, që thoshte: “Krijesat janë krejt nevojtare për All-llahun, më i dashuri i tyre për Të, është më i dobishmi i tyre për krijesat e Tij!”.

Dhe, unë mendoj se shoqëritë njerëzore sot, janë nevojtare për modelin e muslimanit; njeriut të paqtë, dhuruesit të sigurisë, shembullit në mirësjellje, ndërtuesit të urave të komunikimit, njeriut-NJERI, atij që pa paragjykim pret edhe terroristin e fshehur vrastar me buzëqeshje dhe me një: “Hello brother!” të sinqertë, ndonëse muslimani dhe terroristi qëndrojnë larg njëri-tjetrit, si vetë polet e kundërta..!

Islami nuk ju urren, zotëri!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

Shkodër, 25 mars 2019

H. BUJAR SPAHIU, KRYETAR I RI I KOMUNITETIT MYSLIMAN TË SHQIPËRISË



Këshilli i Përgjithshëm i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë zhvilloi sot mbledhjen e tij të zakonshme për zgjedhjen e kryetarit të ri të institucionit.

Pas votimit të myftinjve të rretheve, anëtarëve të kryesisë së KMSH-së dhe anëtareve të Këshillit të Përgjithshëm, z. Bujar Spahiu u zgjodh Kryetari i ri i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë me një mandat 5-vjeçar.

BUJAR SPAHIU

Ka lindur më 26 shkurt 1976 në Kukës.

Pasi mbaroi arsimin 8-vjeçar në Shkollën "Lidhja e Prizrenit në Kolesjan, ai u bë pjesë e kontingjentit të parë të studentëve që u nisën nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë drejt Turqisë në vitin 1992.

Kështu më 1996 ai kreu Medresenë Bejkoz në Stamboll, Turqi.

Më pas ai kreu studimet

Teologjike universitare dhe pasuniversitare në Universitetin e Ez'herit në Egjipt në vitin 2003 në fushën e Tefsirit (interpretimi i Kuranit).

H. Bujar Spahiu ka një kontribut të gjatë në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, ku ka shërbyer si drejtor në Drejtorinë e Arsimit në KMSH nga viti 2006 deri në vitin 2009, dhe nga vitit 2009 deri në vitin 2019 ka ushtruar detyrën e nënkryetarit në këtë institucion.

H. Bujar Spahiu ka marrë pjesë dhe ka përfaqësuar Komunitetin Mysliman në shumë takime të rëndësishme, organizime të ndryshme, konferenca, simpoziume, etj.

Gjithashtu Spahiu ka qenë i angazhuar në mësimdhënie në universitet dhe medresetë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë në fushën e specializimit të tij.

Z. Spahiu është i martuar dhe ka dy fëmijë, një djalë dhe një vajzë.

(www.kmsh.al)



PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:

"Fjalët më të mira janë katër; nuk të dëmton me cilëndo të fillosh: Subhanall-llah, Elhamdulil-lah, La ilahe il-lall-llah, All-llahu ekber!"

(Transmetuar nga Ibn Maxheh)

ME ZEMËR TË MIRË FILLIMIN E TRE MUAJVE TË MIRË!

Të dashur e të shtrenjtë besimtarë, Nata e parë e Muajit Rexheb të kalendarit hixhri, e quajtur ndryshe si Nata e Regaibit, është nata që i paraprin të xhumasë së parë (nata që lidh ditën e enjte me të xhumanë) të Muajit Rexheb, që është edhe muaji i parë i Tre Muajve të Begatë; Rexheb, Shaban dhe Ramazan.

Ndër vlerat e mëdha dhe të spikatura që përmban kjo natë, është njëkohësisht edhe sihariqi dhe lajmërimi i i parë i afrimit të Muajit Ramazan, të cilin besimtarët e presin me shumë mall.

Dashje pa dashje, besimtari hyn në një atmosferë të ngrohtë shpirtërore, duke u kthyer me pendim të sinqertë, me agjërim e lutje, me rregullim të programit të namazeve ditore, por jo vetëm, nga dyert e kërkimit të mëshirës dhe faljes nga All-llahu i Madhëruar.

Meqë Muaji Rexheb është prej muajve, në të cilët ndalohej padrejtësia dhe e keqja në përgjithësi, muslimani forcohet edhe më shumë në vetëdijen e tij se, Njeriu, si mëkëmbësi i Zotit në Tokë, është krijuar si ndërtues vlerash në jetë, si përhapës i paqes, si përçues i të mirës dhe mbrojtës i jetës, harmonisë, vlerave të humanizmit dhe zhvillimit të jetës në përgjithësi.

Me këtë rast, më lejoni t'ju përhapoj me zemër dhe t'ju ftoj që bashkarisht t'i drejtohem me lutje e përgjërime Zotit të gjithësisë, që të na mbushë zemrat me dashninin e Tij, të na kthejë nga e mira, të na hapë dyert e bekimeve në jetë, duke na nxjerrë nga errësira në dritë!

Ju ftoj që duke nisur nga kjo mbrëmje e deri në pritje të Hënës së Bekuar të Ramazanit, të angazhohemi me më shumë namaz nate, tehexhud, agjërim vullnetare, sadaka e ndihmë ndaj njerëzve në nevojë, vizita farefisnore, takime me miq e dashamirë, solidaritet me projektet e ndryshme sociale, që i sjellin dobi qytetit, vendit e kombit!

All-llahu ju dashtë e ju bekoftë!

Myfti i juaj

Shkodër, më 7 mars 2019

23 MARS 2007, NJË DITË BAJRAMI PËR SHKODRËN..!

Kaluan plot 12 vite nga ajo ditë e shumëpritur e përrurimit zyrtar të xhamisë së Parrucës.

Ende kam të freskëta në kujtesë detajet e organizimit të ceremonisë, përgatitjen e ftesave, emocionet e krejt grupit të madh të angazhuar për suksesin e asaj dite të paharruar...

Ndonëse ishte mot me vranësi, pranvera që dhuronte shfaqja e xhamisë së plotësuar, kthente grinë në të bardhë, ndërkohë, ndonjë piklinë shiu, që shfaqej hera-herës si për të përhapur xhaminë e re, ndjehej si bekim hyjnor, në prag të momentit të shumëpritur...

Nuk e di se kush ishte më i ngarkuar me emocione e kush më pak, por kam bindjen se atë ditë, pjesa më e madhe e të pranishmëve që kishin tejmbushur sheshin e Parrucës, e ndjenin me shpirt se, kjo ditë kishte marrë dritën e ditëve të bajrameve, që të gjithë i presim me lutje e gëzim, që s'përkruhet!

Ashtu erdhi ajo ditë e bekuar e të xhumasë, më 23 mars 2007.

...

Përfitoj nga rasti të rishfaq mirënjohjen e përsëritur të Myftinisë Shkodër, timen personale (si Myfti i Shkodrës, por edhe si qytetar i saj), për donatorin kryesor të kësaj xhamie, z. Seit Fishta dhe bashkëpunëtorët e tij! Kjo mirësi e bërë, u kthye në shembull të bekuar të një fryme të re dhe dëshmie të madhe se, muslimanët e Shkodrës,

nuk e humbën shpirtin e fesë dhe besën e All-llahut..!

Shpreh mirënjohje për imamët e nderuar: Alban Kali, Naim Drijaj dhe Durim Kasemi, si dhe për muezinët e palodhur: H. Daut Shabaj (rahmet pastë), për të palodhurin H. Besnik Saraçi, për të kudogjendurin në shërbim të kësaj xhamie dhe kontributeve të vazhdueshme në dobi të saj, H. Besnik Elbasani dhe krejt bamirësit e kontribuuesit në vazhdimësi për të mirën e kësaj xhamie dhe simbolikës së saj për bashkësinë tonë dhe mbarë qytetin!

Shpreh mirënjohjen time për të gjithë imamët e nderuar të Shkodrës, që në momente të caktuara dhe sipas programeve të larmishme të organizuara nga institucioni i Myftinisë, dhanë kontributin e tyre të çmuar, duke rrezatuar dije dhe kulturë besimi nga minberi dhe kursija e kësaj xhamie.

Poashtu falënderoj të gjithë kolegët e mi të nderuar, myftilerët e qyteteve të tjera, si dhe personalitetet e shquara të Thirrjes Islame në rang kombëtar, rajonal dhe botëror, që ligjëruan nga kjo xhami me ftesën tonë. All-llahu i shpërbleftë!

23 mars 2007, ishte dhe mbeti një ditë bajrami për Shkodrën dhe besimtarët e saj!

Imam Muhamed B. Sytari

Shkodër, 23 mars 2019





Samir Repishti, PhD.*
(Ridgefield, CT - USA)

Falemnderit o Perendia e lotëve tonë të heshtun!” (Lutje e afro-amerikanëve)

Ridgefield, CT.- Pa dyshim jetojmë në një botë me të papritura të përditëshme: shumica e tyre të padëshirueshme; mjaft prej tyre me karakter tragjik dhe përpjestime masive.

Ka shumë spjegime, ka shumë përcaktime të kësaj situatë të vështirë dhe të rrezikshme. Ajo që shqetëson ma shumë është përdorimi i papushim i fjalës: urrejtje - një përbuzje e fortë e shoqënueme me vullnet të keq e dëshirë për shkatërrim! Kudo që ngjasin trazime që na shqetësojnë gjindet një spjegim: urrejtja. Kudo që konfliktet gjakosin masat e pafajshme spjegohen me fjalën: urrejtje. Përpjekjet tona me krijue një atmosferë ku njeriu të afrohet me njeriun si vëllau me vëlla duket sikur janë fjalë pa kuptim në këte botë të çoroditur që refuzon të mirën, që përqafton të keqen, dhe që shkatërron dalë nga dalë, por me siguri, arritjet e qytetnimeve mijëvjeçare të të gjithë kontinenteve, tue damtue randë frymën e shpresës për një të ardhme ma të mirë...

ASHTË TRAGJEDIA E BOTËS SONË BASHKËKOHORE!

Me 15 mars 2019, ditën e premte (xhuma), ditë e shenjtë për afër 1.4 miliard besimtarë myslimanë në botë, në qytetin Christchurch, Zelanda e Re, një burrë i armatosun dhe me “camera” në kokë për fotografim, u drejtue kah Xhamia Al Nur dhe hapi zjarr me armë automatike kundër cilitdo që shikoi ose takoi ose që rastësisht i doli para. Gjashtë minuta ma vonë, ai u drejtue kah Xhamia Linwood dhe zbrazti armët përsëri mbi besimtarët që luteshin dhe kërkojshin falje e mëshirë nga Zotit, akti ma domethanës i krijesës ndaj Krijuesit.

NË KËTË BOTEN TONË TË ÇORODITUN...

Akti i terrorit masiv u transmetue “i lirë” për të gjithë botën me u pa në mediat e informimit.

Numri i viktimave të vramë arrijti shifrën 50 (pesëdhjetë) dhe ma shumë se 54 (pesëdhjetë e katër) u plagosën gjatë lutjes fetare, e tani po shërohen në spitalet e vendit. Tragjedia e një qyteti të vogël preku zemrat e botës mbar!

I dyshuemi u arrestue. Ai quhet B. H. T, 28 vjeçar, ekstremist supremacist i bardhë me urrejtje për emigrantët. Video-ja e prodhueme, dokumentar prej 17 minutash, është rasti i parë ku një vrasës tregon në film aktin e tij -kriminal në esencë dhe grotesk në formë,- një dokumentacion okular i aftësisë së njeriut me zbritë poshtë, poshtë, jashtë botës njerëzore. Inhumanity! Tue folë para Parlamentit, Kryeministri Zonja Ardern shqiptoi këte sentencë madhështore që unë respektoj sot:

“Ai është terrorist, është kriminel, është ekstremist. Por sa herë që do të flas, unë nuk do të përmend emrin e tij. Ju bëj thirrje që sa herë të flisni të përmendni emrat e atyre që u shuan dhe jo emrin e atij që u mori jetën. Ai mund të ketë dëshiruar të bëhet i famshëm, por për ne, këtu në Zelandën e Re, nuk do t’ia ofrojmë këte.” (VoA)

Monumentale! Sentencë që vlen për kriminelët e çdo kohë dhe çdo vendi!

Vrasësi 28 vjeçar T, qytetar australian, që udhëtoi nga Australia në Zelandën e Re, nacionalist ekstrem e i vetë-shpallun, i bardhë, sot i akuzuem për vrasjet masive....dënon “myslimanët” dhe i quen të gjithë “emigrantët” “pushtues”, simbas një manifestos prej afër 70 faqesh, ku elaboron “filozofinë” e tij, të një mendje të smurë. Një qendrim i këtill është i ngjashëm me atë të Presidentit Trump të SHBA-së që quen “emigrantët” e Amerikës latine “invadues” të SHBA-së, tue nxitë kështu urrejten kundër tyre. Në fakt, kriminelit quen Presidentin Trump “...symbol i sotëm i racës së bardhë....” E pabesueshme!

Vrasësi i 50 myslimanëve dhe plagosësi i 54 të tjerëve në dy xhamitë e qytetit Christchurch, Zelanda e Re, ka udhëtue edhe në Ballkan (2016-2018) simbas Zërit të Amerikës. Në fund të vitit 2016, kriminelit ka vizitue Serbinë, Malin e Zi, Bosnjen dhe Kroacinë, ku ka

pa vendet e fushë-betejave historike, raporton agjencia Reuter, dhe është kthye përsëri në 2018. Ai ka vizitue shumë herë edhe Turqinë, dhe ka kalue atje kohë të gjatë, deklaroi një zyrtar i naltë i qeverisë turke. Nuk ka shenime akoma në se ka vizitue Shqipërinë dhe Kosovën.

Qyteti Christchurch, Zeland e Re ka një bashkësi të vogël myslimane, afërsisht 1.000 persona. Në përgjithësi, vendësit e dënuen randë këte akt agresiv e kriminal. “Na dënojmë dhunën dhe urrejtjen e çdo lloji dhe bashkohemi me të gjithë të tjerët, në Zelandën e Re duke shprehur trishtim të thellë për ata që janë damtue nga një ngjarje e tmerrshme” deklaroi Komisioni për të Drejtat e Njeriut të Zelandës së Re. “Nuk ka vend për urrejtje në Zelandën e Re...!”

Ajo që shqetëson ma shumë është përdorimi i papushim i fjalës: urrejtje - një përbuzje e fortë e shoqënueme me vullnet të keq e dëshirë për shkatërrim! Kudo që ngjasin trazime që na shqetësojnë gjindet një spjegim: urrejtja. Kudo që konfliktet gjakosin masat e pafajshme spjegohen me fjalën: urrejtje.

KM i Zelandës së Re, Zja J. Ardern, tregoi naltësinë e saj shpirtënore kur deklaroi:

“Ata (myslimanët) kanë zgjedhë Zelandën e Re si shtëpi të tyre, dhe kjo tokë është shtëpia e tyre. Ata janë në!... Terroristët vranë njuzelandezët!”

Në një shkrim të botueme në The New York Times (16.III.2019), shkrimtari Steve Braunias, nga qyteti Te Atatu (Z. e R.) përshkruen:

“...vrasjet në dy xhamitë janë diçka e re për ne, diçka që nuk përputhet me ne. Ky akt ka qenë i organizueme, i planifikueme, masakër në shkallë të

gjanë kundër të pafajshmëve, masakër e kryeme nga një vrasës o ma shumë se një, me një kokë të mbushun me material militantësh, zakonisht një logjikë e supremacistëve të bardhë, me frikën dhe përbuzjen e emigrantëve...”

Kjo urrejtje për myslimanët u theksue sidomos mbas masakres së 9 shtatorit 2011, me shkatërrimin e dy kullave të nalta në New York City, me afër 3.000 viktima. Unë ruej përjetë kujtimin e pamjeve televizive të viktimave që preferuen me vdekë tue kërcye nga dritaret e kateve të nalta në pamundësi largimi, e me evitue djegjen për së gjalli nga zjarri që dogji gjithçka dhe të gjithë nëpunësit e ndërtesave madhështore. E ndjeva vetën të turpnuem nga akti i një grupi 19 terroristësh që përdorënen time me djegë për së gjalli afër tre mijë persona....! Mbrenda zemrës sime, fillova të ndiej një dallim nga “të tjerët”, dhe një nxitje me u përmirësue edhe ma shumë që të ishe i denjë për një qenie njerëzore me dinjitet, dhe pjesëtar i një shoqënie pa kompleksin e fajit... Me përdorë një shprehje te shkrimtarit Omer Aziz, “.... e gjithë kjo gjendje nuk ishte me ruejtje një lloj politike të respektit publik, por një akt i vetë-mohimit....”.

Masakra në Zelandën e Re fillon me ide, e perfundon me dhunë të randë, është opinionit i përgjithshëm i shprehun në shtyp. Aty lexohet se kriminelit që hyni ne xhami u përshëndet me fjalët: “Mirësevjën, vëlla!” Por myslimanët janë shpeshherë të paraqitun si popull luftarak, i paqytetnuem; megjithëse, e kundërta është e vertetë! Një fe që na ka dhanë qytetnimin arab për shumë shekuj nuk mund të jetë faktor anti-qytetnues! Myslimanët kërkojnë të pranohen në vende të qeta dhe të mira, me quejtë “të bardhët” që hyjnë në xhami “vëllau i im”...dhe nuk meritojnë një përgjigje me automatik.

Viktimët e dy xhamive në Christchurch u likuiduen jo vetëm nga një personë plot me urrejtje, por edhe nga idetë e superioritetit racial që ekzistojnë në vend. Kështu ngjau në Quebec, Canada, në vitin 2017, ku myslimanët u vranë me duzinë gjatë lutjeve fetare. Kështu në 2018 u vranë hebrejtë në sinagogen e Pittsburgut sepse “kishin strehë emigrantët” e Amerikës latine”. Kështu ishte në Norvegji disa vjet ma parë kur një supremacist i bardhë vrau 77 djelm e vajza të reja në kampin veror (një vajzë ishte shqiptare). Kështu ishte në Charleston, S.C. tre vjet ma parë kur një supremacist i bardhë vrau 9 persona

Krimineli që hyni ne xhami u përshëndet me fjalët: “MIRËSEVJËN, VËLLA!”
Por myslimanët janë shpeshherë të paraqitun si popull luftarak, i paqytetnuem; megjithëse, e kundërta është e vertetë!
NJI FE QË NA KA DHANË QYTETNIMIN ARAB PËR SHUMË SHEKUJ NUK MUND TË JETË FAKTOR ANTI-QYTETNUES!
Myslimanët kërkojnë të pranohen në vende të qeta dhe të mira, me quejtë “TË BARDHËT” që hyjnë në xhami “VËLLAU I IM”...dhe nuk meritojnë një përgjigje me automatik.

gjatë lutjes, dhe priftin e tyre. Njeriu ka përshtypjen që një patologji e urrejtjes është përhapë në të gjithë botën, dhe rrezikon jetët tona çdo ditë.

Me dhimbje duhet të pranojmë se “Islamofobia” (urrejtja për çdo gjë myslimane) nuk është ma një fenomen i rastësishëm, por një problem i ngulun thellë në shoqëninë perëndimore. Për disa dekada të gjata, bashkësia myslimane “umma” ka qenë e detyrueme me pranue fajin kolektiv dhe dënimin nga të tjerët për aktet e një grupi fanatikësh të aftë për terror e dhunë. “Ne e dimë pse e kreu këte akt. Ai e bëri për hakmarrje për vrasjet me kamione që myslimanët kanë ba (në Europë)” deklaroi një racist njuzelandez.

Definicioni i “racizmit” nuk mund të kuptohet si duhet në se jemi të pa aftë me dallue se krimi ashtë krim, qoftë i kryem nga ai që lutet në xhami ose në tempullin e tij. Sot, miljona qytetarë mendojnë se problemi është “Islami” si fe dhe si kulturë. Kjo ka sjellë në përfundimin: në se “Islami” është problemi, atëherë duhet të kemi kujdes e të ruhemi nga 1.4 miliard myslimane. Ndiqni nga, mos i lejojnë me ardhë në vendin tuej, ashtu si këshillon Presidenti Trump. Idetë krijojnë situata të damshme, sepse merren seriozisht nga shumë qytetarë. Edhe në qoftë se vetëm një kriminel aplikon këto ide, përfundimi është një masakër.

KY ASHTË MËSIMI QË MARRIM SOT NGA ZELANDA E RE....!

“Në se dikush sulmon një hebre, shkruente Hannah Arendt, çdo njeri

nga ne duhet të mbrohet si hebre” Kur ju sulmoheni si mysliman, ju duhet të mbroheni si mysliman. Dhe sot të gjithë jemi myslimanë - të gjithë ne që jemi të dedikue me mbajtje të gjallë dritën e qytetnimit tonë, tolerancën e paqen tonë, shpëtimin e shoqënisë sonë nga barbarizmi primitiv këtyne mendjeve gjysmake dhe të helmueme.” përfundon Omar Aziz, në komentin e tij.

Ndërkaq, popullsia e qytetit Christchurch mbetet e tronditur për jetë. Kërkesë falje ndigjohet kudo. Familja e kriminelit shpreh keqardhjen e saj për këte sulm banditesk, dhe shprehen se janë “të tronditur thellë”. Kryeministri Ardern u zotue se “do të bahen ndryshime në ligjët për blemjen e armëve”. Familjarët e kriminelit u drejtuen familjarëve të viktimave: “Jemi shumë të prekun për të gjithë të vdekunit dhe të plagosunit,” tha xhaxhai i kriminelit. “Nuk jemi në gjendje të mendojmë ndryshe e për çdo gjë tjetër. Na duem vetëm me shkuë në shtëpi e me u mshehë”. Gjyshja e kriminelit, 81 vjeçare, tha: “Na e kemi humbë fare. Na nuk dimë as çka të mendojmë...!” Popullsia e krishtenë e qytetit hapi fondin e ndihmës dhe grumulloi mbrenda një dite shumë prej 638.000 dollarësh për familjet e viktimave.

Para një tragjedie të këtill asnjëri nga ne nuk gjen sot forcën e duhur me mendue qart.

Mbeten vetëm forca e lutjes dhe ndjenja e faljes së fajit, dy qendrimet që na naltësojnë!

* Veprimtar për të drejtat e njeriut.



Naim Driaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Allahu i lartësuar thotë: “Zoti yt krijon dhe përzgjedh çfarë të dëshirojë”.¹

1. MUAJI MUHARREM

1. Muaji Muharrem është muaji i parë i kalendarit Islam (hixhri) të cilin e caktoi kalifi i dytë i myslimanëve, Omer ibnul-Hattabi (r.a).

2. Muaji Muharrem është një prej katër muajve të shenjtë.

Allahu i lartësuar thotë: “Vërtet, numri i muajve tek Allahu është dymbëdhjetë”,² sipas Librit të Allahut, që prej ditës kur krijoi qiejt dhe Tokën. Katër prej tyre janë të shenjtë, sipas besimit të drejtë...³.

Emrat e këtyre katër muajve të shenjtë nuk janë përmendur në Kur'anin Famëlartë, por janë përmendur në hadithet e Profetit (a.s). Nga kjo kuptojmë se suneti i Profetit (a.s) dhe hadithet e tij janë të domosdoshme dhe jetike për interpretimin dhe komentimin e ajeteve kuranore. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Viti ka dymbëdhjetë muaj. Katër prej tyre janë të shenjtë, Muharrem, Rexheb, Dhul-kade dhe Dhul-hixhe.”⁴

3. I Dërguari i Allahut e ka cilësuar këtë muaj: “Muaji i Allahut, Muharremi.”⁵

4. Agjërimi në muajin Muharrem është më i dashur tek Allahu (xh.sh) sesa në çdo muaj tjetër, përveç Ramazanit.

Ngjarjet historike në muajin Muharrem

1. Muaji Muharrem na kujton triumfin e Musait (a.s) ndaj faraonit. (Kjo ka ndodhur 10 Muharrem).

2. Në këtë muaj ndodhet dita e Ashures. Pejgamberi (a.s) ka thënë:

1. Kur'ani, El-Kasas: 68.
2. Kalendar i hixhri ka 12 muaj me nga 29 ose 30 ditë.
3. Kur'ani, Et-Teube: 36.
4. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
5. Transmetuar nga Muslimi.

DATA TË RËNDËSISHME NË MUAJT E SHENJTË

“Shpresoj nga Allahu i Lartësuar se agjërimi i ditës së Ashures do të bëhet shkak që të falen gjynahet e vitit të kaluar.”⁶

3. Në këtë muaj ka ndodhur ngjarja e elefantit. Kjo ngjarje ka ndodhur 55 ditë para së të lindte Profeti (a.s). (Kjo ngjarje tregohet në suren Fil).

4. Bojkoti tre vjeçar (ekonomik dhe shoqëror) ka ndodhur në vitin e 7-të të Profetësisë dhe pas tre viteve në vitin e 10-të të Profetësisë anulohet.

Qëllimi kryesor i kurejshitëve me këtë bojkot, ishte që fisi Benu Hashim, ose të dorëzonte Muhamedin (a.s) ose të shpallet që ai ka hequr dorë nga idetë e tij.

5. Në vitin e 7-të të hixhretit kemi letrat që Profeti (a.s) u dërgoi sundimtarëve të kohës që të praninin islamin.

6. Në vitin e 7-të të hixhretit në fund të muajit Muharrem ka ndodhur beteja e Hajberit me çifutët.

2. MUAJI REXHEP

Muaji Rexheb është muaji i shtatë sipas kalendarit hixhri dhe është një nga katër muajt e shenjtë.

Disa ngjarje të rëndësishme që kanë ndodhur në muajin Rexheb:

1. Në vitin e pestë të profetësisë kur Pejgamberi (a.s) ka qenë në moshën 45 vjeçare, ka ndodhë emigrimi (hixhreti) i parë për në Etiopi (Abisini).

2. Beteja e Tebukut ka ndodhur në vitin e nëntë të hixhretit në muajin Rexheb.⁷

3. Çlirimi i Kudsit nga Salahudin Ejubi ka ndodhur me 27 Rexheb 583 h.

4. Imam Shafi'u, Allahu e mëshiroftë, prijësi i medhhebit shafi dhe po ashtu një nga dijetarët e mëdhenj të ymetit islam ndërroi jetë në muajin Rexheb, në vitin 204 h.

5. Imam Muslimi (Ibnul-Haxhaxh el-Kushejri) përmbledhësi më i saktë i haditheve të Pejgamberit (a.s) pas Buhariut ndërroi jetë në muajin Rexheb, në vitin 261 h.

6. Imam Neveviu ndërroi jetë me 24 Rexheb në vitin 676 h.

7. Në këtë muaj ka ndodhur mrekullia e Israsë dhe Miraxhit.

6. Transmetuar nga Muslimi.
7. Tefsir Et-Taberi: 14/540-542.

3. MUAJI DHUL-KADE

Ky është muaji i parafundit i kalendarit islam dhe është nga muajt e Haxhit.

Disa ngjarje me rëndësi që ndodhën në këtë muaj:

1. Hilful-Fudul⁸- Arabët lidhën një aleancë të cilën e quajtën “aleanca e fudulit” aleancë që shërbente për përkrahjen e secilit që i ishte bërë padrejtësi. Në këtë kohë Muhamedi (a.s) akoma nuk ishte bërë Profet, por nga kjo aleancë mësoi mënyrën se si nënshkruheshin marrëveshjet dhe si lidheshin aleancat.

Këtë marrëveshje Profeti (a.s) e ka përmendur edhe pasi është bërë Profet dhe ka thënë: “Sikur të thirresha të merrja pjesë edhe tani që jam në Islam, do të pranoja”.

2. Në datën 30 të vitit 5 h. (625), Pejgamberi (a.s) bëri betejën me fisin Benu Kurejdha të jehudive.

3. Në vitin 6 h. (626), në fillim të këtij muaji ndodhi marrëveshja e Hudejbijes.

4. Beteja e Hendekut. Kjo betejë ka ndodhur me 8 Dhul-Kade në vitin e pestë të hixhretit.

4. MUAJI DHUL-HIXHE

Muaji Dhul-hixhe është muaji i dymbëdhjetë i kalendarit islam.

Disa ngjarje me rëndësi që ndodhën në këtë muaj:

1. Udhëzimi në Islam i Hamzait dhe tre ditë pas tij e pranon Islamin edhe Omeri (r.a).

2. Në vitin e 10-të të hixhretit ka ndodhur haxhi i Lamtumirës.

3. Në datën 26 të vitit 23 h. (644), ndërroi jetë udhëheqësi i muslimanëve, Omer ibnul-Hattabi (r.a) në moshën 63 vjeçare.

4. Në datën 18 të vitit 35 h. (656) ndërroi jetë udhëheqësi tjetër i muslimanëve, Othman ibn Affani (r.a).

5. Vlora e 10 ditëve të Dhul-hixhes, Haxhi, Dita e Arafatit dhe Kurban Bajrami.

6. Mbyllja e vitit me ibadet dhe fillimi i vitit përsëri me ibadet. Allahu i lartësuar thotë: “Adhuroje Zotin tënd deri sa të vijë vdekja.”⁹

(Ligjëratë e mbajtur, më 14 mars 2019 në xhaminë e Parrucës)

8. Fudul vjen nga fjala *fadl*, e cila nënkupton fisnikëri, superioritet dhe virtyt.
9. El-Hixhr, 99.

PYETJET E KRIJUESIT NDAJ KRIJESAVE TË TIJ!

KUSH KRAHASOHEK ME ZOTIN GABON...

Atëherë, a është njësoj si Ai që krijon, si ai që nuk krijon?! A nuk po merrni vesh? (En-Nahl: 17)

Një nga çështjet e para të trajtuara nga Kur'ani Famëlartë është çështja e “hyjnizimit”. Zoti i Gjithësisë dënon qasjet e cilitdo që mundohet të barazojë idhujt apo çdo gjë tjetër me Krijuesin Fuqplotë:

Allahu e krahason shembullin e skllavit, që s'ka mundësi për asgjë dhe që është pronë e të zotit me atë që Ne i kemi dhënë plot begati, prej të cilave jep fshehtazi dhe haptazi. A janë njëllot? Lavdi i qoftë Allahut! Shumica e tyre nuk dinë. (En-Nahl: 75)

Patëm cekur që kur krahasojmë të verbrin me atë që sheh dhe themi se “nuk janë të barabartë” këtu nuk kemi për qëllim pozitën shpirtërore që ata kanë tek Allahu. Pozita e një të varfri që bën sabër mund të jetë më e lartë sesa e një të pasuri që pak falënderon, e po kështu një i verbër i devotshëm me një të hutuar; e një personi pasuria e të cilit edhe pse është minimale ai jep gjysmën e saj me një person që zotëron pa kufi por jep në mënyrë të kufizuar.

Njerëzit si mund t'i japin atribut hyjnore gurit, drurit, skulpturave etj. në jetën e tyre të përditshme? Sipas komentuesve të Kur'anit fjala “Lavdi i qoftë Allahut!” të cekur në ajetin e mësipërm, është një lloj aprovimi i një mendjeje të shëndoshë që “sigurisht nuk kanë si të jenë njëllot”. Gjithsesi ka prej atyre që nuk logjikojnë me një mendje të shëndoshë e kësisoj adhurojnë ca krijesa të pafuqishme e i nënshtrohen atyre.

Ajeti vijues:

Gjithashtu, Allahu krahason në suren En-Nahl: 75, shembullin e dy njerëzve, njëri prej të cilëve është shurdh-memec, nuk mund të bëjë asgjë dhe është barrë e pronarit të vet, - kurdo e kudo që ta dërgojë, nuk i sjell asnjë të mirë. A është i barabartë ky me atë që urdhëron për drejtësi dhe ndjek rrugën e drejtë?!

Ja një tjetër ajet që tregon se nuk janë të barabartë besimtari me idhujtarin duke na bërë me dije se idhujtari është futur në një rrëmujë të madhe:

Dëgjojeni këtë shembull që ka sjellë Allahu! Janë dy njerëz: njëri ka shumë bashkëpronarë që e kundërshtojnë

njëri-tjetrin, ndërsa tjetri ka vetëm një pronar, të cilit i përkushtohet. A janë të njëjtë ata në krahasim?! Lavdëruar qoftë Allahu, por shumica e tyre nuk e dinë këtë! (Ez-Zumer: 29)

Thënë ndryshe, një idhujtar është si një punëtor i hutuar i cili ka shumë pronar, ndërsa monoteisti ka vetëm një vend ku do japë llogari.

Feja e vetme e pranuar tek Allahu është Islami. Nuk ka gjasa që të pranohet në këtë fe cilido që lyp diçka përtej saj... Të tillët janë në humbje. E në humbje është cilido që bën pjesë në një fe tjetër pos Islamit.

GJITHSESI KA PREJ ATYRE QË NUK LOGJIKOJNË ME NJË MENDJE TË SHËNDOSHË E KËSISOJ ADHUROJNË CA KRIJESA TË PAFUQISHME E I NËNSHTROHEN ATYRE.

BESIMTARI DHE MOHUESI

Le të lexojmë:

Vallë, a është besimtari njësoj si keqbërësi? Jo, ata nuk janë të barabartë. (Es-Sexhde: 18)

Fakti që ata tek Allahu nuk janë të barabartë shpie në përfundimin se edhe fundi i tyre është po aq i ndryshëm. Në dy ajete që pasojnë njëri-tjetrin bëhet e ditur se besimtarët do jenë banorë të Xhenetit e ndërsa të prishurit do dergjien në Xhehennem: Për ata që ruhen (nga gjynahet), tek Allahu do të ketë kopshte të kënaqësive. Vallë, a t'i trajtojmë ata që Na nënshtrohen njësoj me keqbërësit?! Çfarë keni ju (jobesimtarë)? Si po gjykoni kështu?! (El-Kalem: 34-36)

Këto ajete janë kundërpërgjigje e fjalëve të kota të mohuesve të cilët vetë Kur'ani i përmend si: edhe nëse do të më kthejnë te Zoti im, sigurisht që do të gjej një vend më të mirë se ky kopsht (El-Kehf: 36, Fussilet: 50) Në njëren anë ngjashmëria në dukje midis besimtarit

dhe jo besimtarit, në anën tjetër dallimi i madh që ekziston midis tyre tregohet përmes shembullit të deteve që takohen por nuk përzihen: Edhe dy detet (llojet e ujit) nuk janë të njëjta: njëri është i ëmbël e i këndshëm dhe uji i pihet me shije, kurse tjetri është i njelmët dhe i hidhët. (Fatir: 12)

Në gjuhën e përditshme shpesh bëhet një krahasim i gabuar i tipit: edhe ai që krijon varësi ndaj alkoolit vdes, edhe ai që nuk e konsumon fare atë vdes, fundja të gjithë vdesin...

Sigurisht të gjithë vdesin, po më pas?

Le të lexojmë:

Ata që i shtrembërojnë shpalljet Tona, nuk mund të Na fshihen. Si mendoni, a është më i mirë ai që do të hidhet në zjarr apo ai që në Ditën e Kiametit do të vijë i sigurt? Bëni ç'të doni, se Ai i sheh të gjitha çfarë punoni ju. (Fussilet: 40)

Nuk është i barabartë besimtari me jo besimtarin, as vendi ku do të arrijnë nuk është i barabartë. Atëherë është e domosdoshme të konsolidohet ky ndryshim që në jetën e kësaj bote.

Le të lexojmë:

A është më mirë ai që shkon rrëshqanas e kokulur apo ai që ecën ballëllart në rrugën e drejtë? (El-Mulk: 22)

Vallë, a është i njëjtë ai që i përmbahet udhëzimit të Zotit të tij me atë që i zbukurohen punët e veta të shëmtuara dhe lëshohet pas pasioneve të veta? (Muhammed: 14)

Vallë, a mund të krahasohet ai që kërkon kënaqësinë e Allahut me atë që ka merituar zemërimin e Allahut dhe strehimi i tij është Xhehenemi?! Eh, sa strehim i keq është ai! (Ali Imran: 162)

Cili është më i mirë, ai që themelet e godinës së vet i vë në përkushtimin ndaj Allahut dhe në kënaqësinë e Tij apo ai që themelet e godinës së tij i vë në bregun e gjërryer dhe që rrokulliset me të në zjarrin e Xhehenemit?! Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin keqbërës. (Et-Teube: 109)

Në jetën e kësaj bote shpesh bëhen krahasime të gabuara sa i takon urdhëresave dhe ndalesave të Allahut...

(vazhdon në numrin e ardhshëm)

Autor: **Mustafa Asım KÜÇÜKAŞCI**
(YÜZAKI, Korrik 2018)

Përktheu dhe përshtati: **Elena SYTARI**

JORDANIA, OSE MBRETËRIA HASHIMITE E JORDANISË

Jordania është njëri nga katër vendet e Shamit të përshkruara nga Kurani Famëllartë si tokë e bekuar. Emrin Jordani vendi e ka marrë nga dy lumenj në veri të lumit Jordan, lumenjtë Xhuur dhe Daan. Pra, dikur ky vend më saktë quhej “Xhurdan”. Me evolimin e gjuhës, nga Xhurdan u kthye ne Jordan. Arabët e quanin këtë vend “Urdun”, që do të thotë forcë dhe mbizotërim. gjithashtu thonë se Urdun quhej njëri nga nipërit e Nuhit (a.s), emër me të cilin më vonë u njoh ky vend. Ndërsa nga grekët e lashtë, vendi njihet me emrin “Jordanim”, që do të thotë pjerrësi ose tatëpjetë.

Kur mbreti Abdullah ibn Husein e themeloi Principatën Jordaneze, e emërtoi atë si “Principata Arabe e Lindjes”, pastaj më vonë u njoh si “Principata Jordaneze e Lindjes”, pastaj u bë e njohur si “Mbretëria Hashimite e Jordanisë”, sepse sistemi i qeverisjes atje është monarki, dhe u quajt Hashimite sipas fisit Beni Hashim që e themeluan mbretërinë, dhe këtë emër mban edhe sot.

KU NDODHET JORDANIA?

Jordania është e vendosur në jug-perëndim të Azisë, në pjesën jugore të zonës së Levantit-Shamit, dhe në pjesën veriore të Gadishullit Arabik. Ajo kufizohet me Sirinë në veri, me Irakun në lindje, me Arabinë Saudite në lindje, juglindje e jug, dhe me Palestinën në perëndim.

Kryeqyteti i Jordanisë është Ammani, ndërsa qytete të tjera të mëdha të vendit janë Karak, Ma'an, Akabah, Zarka, Irbid, etj.

Mbretëria Hashimite e Jordanisë e fitoi pavarësinë më 25 Maj të vitit 1946. Ajo ka qenë një nga anëtarët themeluesë të Lidhjes së Shteteve Arabe në vitin 1945, ndërsa në vitin 1955 u anëtarësua në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Mbretëria Hashimite e Jordanisë ka një popullsi prej rreth 6.2 milionë banorësh (sipas një vlerësimi të vitit 2011), dhe një sipërfaqe prej 89,287 kilometrash katrorë.

Valuta e përdorur në vend është dinari jordanez, një monedhë mjaft e fortë.

Feja kryesore në vend është Islami (92% e popullsisë), pastaj vjen krishterimi (8%).

Gjuha zyrtare në Jordani është gjuha Arabe.

DISA NGA KARAKTERISTIKAT E RELIEVIT DHE TË KLIMËS SË KËTIJ VENDI

Sipërfaqja e tokës së Mbretërisë Hashimite të Jordanisë karakterizohet për shtrirjen gjatësore të vendit nga veriu në jug. Zona e luginave të Jordanisë gjendet në pjesën perëndimore të vendit me drejtim veri-jug, dhe pasohet në lindje nga zgjatimi i vargmaleve me të njëjtin drejtim. Në lindje të vendit ndodhet shkretëtira jordaneze.

Luginat jordaneze shtrihen nga cepi veri-perëndimor i Jordanisë deri në cepin jug-perëndimor të saj, dhe ndahen në tri pjesë: Lugina e lumit Jordan, Lugina e Detit të Vdekur dhe Lugina Araba.

Lartësitë malore në Jordani formojnë një ndarje të natyrshme në mes të Luginës së Jordanisë dhe Shkretëtirës Lindore, duke formuar një pllajë me zinxhirë malorë, maja dhe kupola malore, që shtrihen nga lumi Jermuk në veri, e deri në kufirin e Jordanisë me Arabinë Saudite në jug. Lartësia mesatare e kësaj pllaje malore arrin në rreth 1200 metra mbi nivelin e detit, e cila zbret gradualisht drejt lindjes për t'u lidhur me pllajën shkretinore, ndërsa pjesa më e madhe e saj zbret fuqimisht në drejtim të Luginës së Jordanisë në perëndim.

Malësitë, nga veriu në jug, përfshijnë brenda tyre shumicën e rajoneve të banuara të vendit. Këto rajone të vendosura në male janë: Axhlun, Balka', Karak dhe Ma'an. Rajoni i Axhlun-it, në Jordani, është i vendosur në një lartësi prej rreth 850 metra mbi nivelin e detit. Rajoni tjetër që e pason, ai Balka', qëndron në një lartësi mesatare prej rreth 925 metra mbi nivelin e detit. Pastaj vjen Karak, që arrin në një lartësi mesatare mbi nivelin e detit prej rreth 1150 metra, pjesa jugore e të cilit arrin lartësinë më të madhe, ndërsa në pjesën qendrore të kësaj zone reliev pëson një shtrirje, ku janë të vendosura fshatrat dhe qytetet, të rrethuara me toka bujqësore. Zona Ma'an qëndron në një lartësi mesatare mbi nivelin e detit prej rreth 1.300 metrash, atje ku lartësitë Sharat zbresin drejt Luginës Araba në perëndim. Majat malore më të njohura të lartësive Sharat të Jordanisë janë: mali Mubrik (1734 m), mali Harun (1336 m) në jug-perëndim të Petra-s, dhe mali Ram (1754 m). Po në këtë rajon, në rajonin e Ma'an-it, gjendet

edhe mali Ummu Dami (1854 m), që është mali më i lartë në Jordani.

Këto lartësi janë rajonet më të rëndësishme të Jordanisë, pasi në to është e përqendruar pjesa më e madhe e popullsisë së vendit. Në këto rajone gjenden kushtet më të mira për jetesë, si kushtet natyrore e klimaterike, edhe toka pjellore, prandaj atje zhvillohet aktiviteti më i rëndësishëm ekonomik i vendit.

Në rajonet jugore, përqendrimi i popullsisë dhe aktiviteti ekonomik janë më të ulët.

Shkretëtira e Jordanisë, e quajtur gjithashtu edhe si “Shkretëtira Lindore”, është zgjatimi lindor i lartësive malore në Jordani, gjithashtu është zgjatimi verior i pllajës së Arabisë Saudite. Shkretëtira e Jordanisë është vazhdim i Pllajës Shkretinore të Shamit, dhe përbën 75% të sipërfaqes totale të Jordanisë. Kushtet e papërshtatshme për jetesë, e kanë bërë shumë të kufizuar praninë e qendrave urbane atje, madje shumica e sipërfaqes së saj është e pabanuar nga njerëzit.

Kush vështron hartat topografike të Jordanisë, e vëren menjëherë përqendrimin e zonave të banuara nëpër malësi, dhe në një farë mase në luginë, ndërsa në pjesën e shkretëtirës gjen shumë pak ose shumë rrallë të ketë vendbanime.

KLIMA

Klima e Jordanisë është një kombinim i klimës mesdhetare (në zonat malore, ku vera ka klimë mesatare, ndërsa dimri i ftohtë), i klimës gjysmë-tropikale (në luginat e Jordanisë, ku vera është e nxehtë dhe dimri i ngrohtë) dhe i klimës shkretinore (në shkretëtirën jordaneze, ku vera është e nxehtë dhe dimri i ftohtë).

JORDANIA ISLAME

Preokupimi i Bizantinëve me Sasanitët[*], bëri që ta largojë vëmendjen e tyre nga ajo që po ndodhte në Shkretëtirën Arabe.

Pas dëgjimit të thirrjes së Zotit, Profeti Muhammed, paqja e Allahut qoftë mbi të, së pari u përpoq të kthente në besimin e ri njerëzit e shtëpisë së tij, Mekën. Kur mekasit e kërcënuan atë dhe pasuesit e tij, ata morën rrugën për në qytetin fqinj të Medinës, në vitin 622 të e.s. Ky migrim, i njohur si Hixhret, shënon fillimin e kalendarit musliman. Pas luftërash dhe sprovash të vështira me

kurejshitët e Mekës, tetë vjet më vonë, Profeti (a.s) do të rikthehej në Mekë si fitimtar, dhe e gjithë Meka do të hynte në besimin Islam. Që atëherë, besimi i ri u përhap me shpejtësi në të gjithë Lindjen e Mesme dhe në Afrikën e Veriut.

Arabëve muslimanë iu deshën vetëm dhjetë vjet për ta çmontuar plotësisht kontrollin bizantin mbi tokat e Jordanisë, Palestinës dhe të Sirisë. Pas sulmit në vitin 629, kundër qytetit garnizon Bizantin, Mu'te, i cili ndodhet në jug të Ammanit, pranë qytetit Karak, fiset arabe muslimane u riorganizuan për një operacion shumë më të gjerë ushtarak. Në vitin 636, ushtritë muslimane i kapërcyen malësitë e Transjordanisë dhe fituan një betejë vendimtare kundër bizantinëve, në brigjet e lumit Jermuk, i cili ndan kufirin modern midis Jordanisë dhe Sirisë. Kjo fitore u hapi rrugën muslimanëve drejt marrjes së Sirisë, dhe trupat e mbetura bizantine u detyruan të tërhiqeshin në Anadoll vetëm pak vite më vonë.[2]

Toka e Jordanisë ka qenë dera nga e cila Islami hyri në tokat e Shamit-Levantit. Në këtë vend u zhvilluan dy beteja mjaft të rëndësishme, Beteja e Muet'tes dhe Beteja e Jermukut.

Këtu po përmendim shkurtimisht historinë e betejës së Muet'tes, e zhvilluar në Jordani.

BETEJA E MOTAS

Kjo betejë ka ndodhur në vitin e tetë të hixhretit, dhe ishte një prelud për hapjen e vendeve të krishtera. Arsyeja për këtë betejë ishte se i Dërguari i Allahut, paqja qoftë mbi të, kishte dërguar El-Harith ibn Umejr El-Ezdi me një letër të tij, drejtuar mbretit të romakëve. Sharhabil ibn Amru El-Gassani, i cili ishte i emëruar nga mbreti romak në zonën Balka' të vendeve të Shamit, e ndaloi Harithin, e lidhi dhe ia preu kokën.

Vrasja e ambasadorëve dhe e të dërguarve në atë kohë, konsiderohej si një nga krimet më të shëmtuara dhe ishte e barasvlershme me deklarin e luftës. Kjo gjë e shqetësoi shumë të Dërguarin e Allahut (a.s) gjithashtu u erdhi shumë e rëndë edhe muslimanëve. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (a.s) përgatiti një ushtri prej tre mijë luftëtarësh me në krye Zejd ibn Harithe, dhe u tha: “Nëse vritet Zejdi, prijës bëhet Xhaferi, e nëse vritet Xhaferi atëherë është Abdullah ibn Revaha.” (Buhariu).

Ushtria Islame vazhdoi derisa arriti në vendin e quajtur Mean, në Sham, dhe atje morën vesh se armiqtë e tyre kishin mobilizuar turma të mëdha për t'i luftuar muslimanët, pasi kishin mbledhur

njëqind mijë luftëtarë të krishterë nga romakët dhe njëqind mijë luftëtarë të tjerë nga arabët e krishterë. Kur mësuan për numrin e madh të ushtrisë armike, muslimanët u konsultuan mes tyre. Disa prej tyre thanë: “Le t'i shkruajmë të Dërguarit të Allahut, ta vëmë në dijeni për numrin e armikut, e pastaj ai ose do të na dërgojë luftëtarë të tjerë për ndihmë, ose do të na japë ndonjë urdhër dhe ne do ta zbatojmë.” Por, Abdullah ibn Revaha e ndau çështjen duke thënë: “O burra! Për Zotin, ajo që ju po e urreni është pikërisht ajo për të cilën ne kemi dalë ta kërkojmë: Shehadja - rënia dëshmor për hir të Zotit. Ne nuk i luftojmë njerëzit ngaqë jemi të shumtë në numër apo se jemi të fortë, por i luftojmë të mbështetur në këtë fe me të cilën Zoti na ka nderuar, prandaj vetëm përpara, sepse na pret njëra nga dy të mirat: Ose fitore, ose dëshmorë të Zotit.”

Fjalët e tij ndezën ndjenjat e luftëtarëve, dhe Zejd ibn Harithe nxitoi bashkë me ushtrinë për në zonën e Motas (në jug të qytetit Karak, në Sham), ku luftuan kundër romakëve dhe ndodhi një përlëshje e madhe, në të cilën të tre prijësit muslimanë bënë luftë heroike, e që të tre ranë dëshmorë.

Pastaj, muslimanët ranë dakord mbi komandën e Halid ibnul-Velidit, Allahu qoftë i kënaqur me të. Ai e mori flamurin dhe zuri të luftojë në përpjekje për ta shpëtuar ushtrinë nga kjo situatë e vështirë dhe e rrezikshme, duke kryer një tërheqje të organizuar nga vendi i betejës. Luftimi me qëllim tërheqjen është nga operacionet më të vështira ushtarake. Kështu, derisa hyri nata dhe u vu një armëpushim i përkohshëm. Gjatë natës Halidi e riorganizoi ushtrinë dhe pas agimit ai i sulmoi romakët duke vrarë shumë prej tyre, ndërsa nga muslimanët ranë dëshmorë vetëm dymbëdhjetë burra. Më pas, Halidi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, bashkë me ushtrinë e tij, u kthyen në Medinën e Ndritur.

Mund të thuhet se Halidi, me planin dhe me trimërinë e tij, i shpëtoi muslimanët nga disfata e sigurt. Humbjet që pësuan muslimanët nga kjo betejë ishin shumë pak në krahasim me humbjet që pësoi ushtria armike. Tërheqja e ushtrisë Islame në një rast të tillë konsiderohet fitore.

Beteja e Motas ka treguar një nga mrekullitë e të Dërguarit, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, që edhe pse nuk po merrte pjesë në luftë, ai po i vajtonte tre prijësit muslimanë dhe dha lajmin e rënies së tyre dëshmorë, ndërkohë që ata ishin atje larg në vendin e betejës, shumë larg Medinës së Ndritur.

I Dërguari i Allahut (a.s) po u tregonte të pranishmëve pranë tij në Medinë për ecurinë e luftës, sikur po shikonte me sy gjithë se çfarë ndodh, pa gabuar asgjë. Kjo tregon se Zoti i Plotfuqishëm ia kishte bërë të mundur të shikonte se ç'po ndodhte me shokët e tij që po luftonin në tokat e Shamit. Kjo është vetëm një nga shumë mrekulli dhe shenja, që tregojnë se i Dërguari i Allahut (a.s) e merrte shpalljen nga Zoti i Plotfuqishëm.

Transmetohet nga Enesi (r.a), se Profeti (a.s), tregoi për martirizimin e Zejdit, Xhaferit dhe Abdullahut, para se ata të ktheheshin në Medinë, dhe para se të mbërrinin lajmet për ta. Ai (a.s) tha: “E mori flamurin Zejdi, dhe ra dëshmor, pastaj flamurin e mori Xhaferi dhe edhe ai ra dëshmor, pastaj flamurin e mori Ibn Revaha dhe ra dëshmor... pastaj e mori flamurin një shpatë nga shpatat e Allahut, derisa Allahu ua hapi rrugën.” (Buhariu).

Ky hadith, përveç shfaqjes së mrekullisë së Profetit (a.s) vë në dukje gjithashtu edhe vlerat e veçanta të Halid ibnul-Velidit, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, të cilin Profeti e emërtoi si “Shpata e Zotit”.

Ajo që padyshim bie në sy në këtë betejë, është guximi i muslimanëve deri në një gradë të mahnitshme, të cilët vendosën të luftojnë kundër një ushtrie prej dyqind mijë ushtarësh, ndërkohë që ata ishin vetëm tre mijë luftëtarë.

Kur u kthyen në Medinë, disa nga vendasit e panë si zbrapsje nga lufta veprimin e tyre, por i Dërguari i Allahut (a.s) kishte thënë: “Ata nuk janë të zbrapsur nga lufta, por do të kthehen përsëri, në dashtë Zotit!”

Dhe sigurisht, do të vinin përsëri për në betejën e Jermukut...

Beteja e Motas është nga betejat më të rëndësishme që u zhvillua në mes të muslimanëve dhe të krishterëve arabë dhe ata të huaj, sepse ajo është përballja e parë e armatosur mes tyre, betejë e cila tregoi për moralin e lartë të muslimanëve.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

Burimet e përdorura:

* - Mbretëria e fundit e perandorisë Persiane para ngritjes së Islamit (https://www.ancient.eu/Sasanian_Empire/)

<http://www.rjgc.gov.jo/RJG.aspx?PID=165&lang=ar>

http://www.kinghussein.gov.jo/his_islam_crusades.html

<http://www.islamweb.net/media/index.php?page=article&lang=A&id=152172>

SULM TERRORIST DITËN E XHUMA MBI DY XHAMI NË CHRISTCHURCH, ZELANDË E RE

CHRISTCHURCH

Qytetarët e Christchurch të Zelandës së Re, ku të premtën ndodhi sulmi i përgjakshëm terrorist, vendosën lule pranë xhamisë Al Noor, një nga dy xhamitë ku u krye sulmi terrorist.

Ata kishin dalë për të nderuar viktimat e sulmit, i cili u krye në kohën e namazit të xhumasë. Sulmi në xhamitë Al Noor dhe Linwood u krye në një distancë kohore prej 10 minutash, ku u vranë të paktën 49 persona dhe 20 të tjerë mbetën të plagosur.

Mediat lokale thonë se në mesin e të vrarëve janë edhe një vajzë 5-vjeçare dhe babai saj, të cilët u vranë gjatë sulmit terrorist.

Më 15 mars, të paktën 50 persona u vranë kur një terrorist hapi zjarr ndaj besimtarëve gjatë faljes së namazit të xhumasë në xhamitë Al Noor dhe Linwood në qytetin Christchurch të Zelandës së Re.

Në lidhje me këtë sulm terrorist janë ndaluar katër persona, tre meshkuj dhe një femër. Njëri prej të dyshuarve u lirua më vonë.

28-vjeçari Brenton Tarrant, i lindur në Australi, po mbahet si i dyshuar në burgun e sigurisë së lartë në qytetin Auckland dhe përballet me akuzat për masakër.

-Qytetarët vendosën lule në vendin ku u vranë muslimanët gjatë namazit të xhumasë


Mediat lokale thonë se në mesin e të vrarëve janë edhe një vajzë 5-vjeçare dhe babai saj, të cilët u vranë gjatë sulmit terrorist

-RECITOHET KURAN NË PARLAMENTIN E ZELANDËS SË RE PËR VIKTIMAT E TERRORIT

Imami Nizam-ul Hak Thanvi, nga foltorja e parlamentit recitoi ajetet 153-156-të të Sures Bakara. Pas recitimit të ajeteve në gjuhën arabe, imami tjetër, Tahir Navaz, i përktheu ajetet në gjuhën angleze

Në parlamentin federal të Zelandës së Re është recituar pjesë nga libri i shenjtë Kurani për viktimat që humbën jetën në sulmin terrorist ndaj dy xhamive javën e kaluar në qytetin Christchurch.

Sipas transmetuesit publik të Zelandës së Re, TVNZ, seanca e parë e parlamentit pas sulmit terrorist filloi me



Xhamia Al-Noor - Christchurch, Zelandë e Re

recitimin e ajeteve të Kuranit.

Imami Nizam-ul Hak Thanvi, nga foltorja e parlamentit recitoi ajetet 153-156-të të Sures Bakara. Pas recitimit të ajeteve në gjuhën arabe, imami tjetër, Tahir Navaz, i përktheu ajetet në gjuhën angleze. Ajetet e lexuara janë si në vijim

“O ju që keni besuar, kërkonin ndihmë me durim e me të falur, se vërtetë Allahu është me durimtarët (153). Dhe mos thuani për ata që vriten në rrugë të Allahut se kanë vdekur. Jo! Ata janë të gjallë, por ju nuk i vëreni (154). Ne do t’ju sprovovjmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta e edhe nga frytet, por ti përgëzoji durimtarët (155) ! Të cilët, kur i godet ndonjë e pakëndëshme thonë: ‘Ne jemi të Allahut dhe ne vetëm te Ai kthehemi’ (156)”.

“Lutja impresionuese e kënduar nga imami bëri jehonë në parlament”, u tha në lajmin e publikuar në ueb-faqen e TVNZ së bashku me videon nga ngjarja.

“Sot kërkoja nga një grup liderësh fetarë që të hyjnë së bashku me mua në sallën e parlamentit si një tregues i unitetit dhe solidaritetit tonë. Prandaj, lutja e sotme e hapjes do të jetë më e gjatë se normalja”, u shpreh kryeparlamentari Trevor Mallard.

- KRYEMINISTRJA ARDERN: “ES-SELAMU ALEJKUM”

Fjalën e parë nga qeveria, pas hapjes, e mori kryeministrja e Jacinda Ardern, duke e filluar fjalimin e saj me përhëndetjen islame “Es-Selamu Alejkum”.

Ajo përkujtoi personat që humbën jetën në sulmin terrorist.

“Ata ishin zelandez, ata ishin ne. Për arsye se ata ishin ne, ne mbajmë zi për ata”, theksoi Ardern.



Ardern shprehu ngushëllimet ndaj të afërmit të viktimave të sulmit terrorist.

“Nuk është e mundshme që të ndajmë plotësisht dhimbjet tuaja, por në çdo fazë do të jemi me ju”, tha kryeministrja zelandeze.

Ajo gjithashtu falënderoi personat që u munduan ta prandalojnë sulmin dhe policët që kapën terroristin për heroizmin e treguar.

Në sulmin terrorist ndaj xhamisë Al Nur dhe asaj në Linwood më 15 mars në qytetin Christchurch të Zelandës së Re, jetën humbën 50 persona.

-ERDOĞAN: NUK DUHET LEJUAR NORMALIZIMIN E KSENOFOBISË DHE ISLAMOFOBISË

Presidenti Erdoğan u bëri thirrje popujve dhe qeverive perëndimore që të mos lejojnë normalizimin e racizmit, ksenofobisë dhe islamofobisë, ideologjitë që janë në rritje kohën e fundit.

(www.radiojehona.al)

ZELANDA E RE, PREZANTUESI E LAJMEVE VISHEN ME SHAMI DHE SOLIDARIZOHEN ME MUSLIMANËT

Më pak se një javë pas sulmit terrorist të ndodhur mbi dy xhami në Christchurch, ku u vranë 50 besimtarë muslimanë, shumë gra nga Zelanda e Re tani po mbajnë shaminë me qëllim që të solidarizohen me muslimanët e vendit.

Veprimi “Shami për Harmoni” është bërë për të kujtuar se burrat dhe gratë duhet të mbajnë shami në kokë, në shenjë barazie.

Përveç kësaj, në kanalet televizive të Zelandës së Re janë vërejtur prezantueset të cilët po ashtu mbanin shami në kokë si shenjë solidarizimi me familjarët e viktimave të sulmit terrorist, transmeton Gazeta e Re.



Kryeministri i Zelandës së Re Jacinda Ardern pas fatkeqësisë shkoi e veshur me shami në xhaminë ku ndodhi sulmi, ku mori pëlqimin nga shumë njerëz.

Ndryshe një javë më parë në Zelandën e Re, një terrorist i ekstremit të djathtë, 28-vjeçar Tarrent, ka hyrë në dy xhami dhe ka vrarë 50 persona, të cilët ishin duke falur namaz. Terroristi krishterë, Brendon Tarrent e ka filmuar të gjithë masakrën me një kamer trupi.

(www.gazetaere.com)

SADO QË THEMI: “ALL-LLAHU EKBER”, KA ENDE SHPRESË PËR NJERËZIMIN!

Ngjarja e para disa orëve në Zelandën e Re, ku besimtarët në xhami u vranë barbarisht nga një sulm terrorist plot perversitet, më solli ndër mend fjalën e Resulull-llahut (a.s.): “Do të mbërrijë kjo fé, ku ka mbërritur nata dhe dita”!

Ky i sotmi është një lajm që vërteton edhe një herë madhësinë e kësaj fjale të bekuar! Edhe atje larg në Zelandën e Re, rrezet e diellit të kësaj feje të begatë islame, rrezatojnë duke përhapur dritë e mirësi, paqe e harmoni, dije dhe qytetërim!

Të gjithë ju e kujtoni Amar ibn Jasirin, të cilit i vranë nanën dhe babën, sepse ishin muslimanët e parë! Edhe Amarin e ri e kryqëzuan, me qëllim që të hiqte dorë nga besimi, të mohonte All-llahun, Kur’anin, Hz. Muhammedin (a.s.)!

Ndodhia e sotme, më kujton këtë shprehje të madhnueshme të Hz.Muhammedit (a.s.), sikurse më sjell ndër mend ajetin kur’anor: “Po ju menduat se do të hyni në xhennet, pa u provuar edhe ju me shembullin e atyre që ishin para jush, të cilët i patën goditur skamjet e vuajtjet dhe qenë tronditur, sa që i dërguari thoshte, e me te edhe ata që kishin besuar: “Kur do të jetë ndihma e All-llahut”? Ja (u erdhi ndihma) vërtetë ndihma e All-llahut është afër!” – (El-Bekare: 214).

Sot, teksa i lutemi All-llahun të Madhëruar të mëshirojë shëhidët e kimit barbar në Zelandën e Re, teksa ngushëllojmë qeverinë e atij vendi, familjarët, ymetin islam dhe njerëzimin mbarë, na del për detyrë në formë reflektimi me u kthi nga dera e besimit dhe feja e Tij! Na del për detyrë të ndjehemi krenar për udhëzimin në Islam, ndonëse tentakulat e të keqes përpiqen herë pas here të bëjnë rolin e shejtanit të mallkuar, duke i lënduar e mërzitur besimtarët!

Ne tashmë jemi në atmosferën e Muajve të Mirë, ku e kemi për detyrë të reflektojmë rreth kësaj feje të madhnueshme dhe të kthehemi me pendim të sinqertë nga All-llahu i Madhëruar, Zoti i gjithësisë! Kemi nevojë të bëjmë teube, për t’u kthyer nga e vërteta dhe për të ndjerë këtë fé në zemër, për ta ndërë marrëdhënien me All-llahun e Madhëruar në jetën tonë të përditshme: “E mos u dobësoni (fizikisht) dhe mos u dëshpëroni (shpirtërisht) derisa ju jeni më të lartit, po qe se jeni besimtarë të sinqertë”! – (Ali Imran: 139).

Ti, si musliman, je përçues i Fjalës së All-llahut! Ti mban në zemër besimin se, nuk ka zot tjetër në këtë univers, përveç All-llahut! Ti je në hak! Dhe, ai që është në hak, nuk ndjehet kurrë i poshtëruar! Ai që është në hak, nuk ndjehet kurrë i vogël! Ai që është në hak, është përherë krenar, në legjitimitet të plotë, njëkohë që krenaria e tij e besimit e merr për dore për të ndërtuar dhe për të shpërndarë kudo të mirën që mbart me vete në zemër!

Prandaj kemi nevojë sot, të kthehemi nga All-llahu dhe të bëjmë teube, edhe nga disa mendime të mbrapshta, që na sillen në orbitën e mendjes, të përziera shpesh edhe me rrobën e fesë a të kapura pas disa gjoja teksteve fetare, për ta pastuar mendjen nga mendime që mbajnë peng zhvillimin e besimit dhe mendësisë islame në familje e shoqëri, kudo!

Është përhapur gjithandej se, shprehja “All-llahu ekber” është fjalëkalimi i shkatërrimit, i shpërthimit dhe i bombave; në fakt nuk është kështu!

Kemi nevojë të pendohemi tek Zoti i gjithësisë dhe të ndjejmë me zemër se, “All-llahu ekber” është fjalëkalimi që hap dyert e të mirës në jetë! Është fjalëkalimi i ndërtimit të urave në mesin e njerëzve! Është fjalëkalimi i çdo të mire në jetën e racës njerëzore, por jo vetëm! Se, po të ishte e kundërta, nuk do ta shihnim Resulull-llahun (a.s.) duke falur e toleruar në gjendje force e pushteti, kundërshtarët e tij të zënë rob lufte, ditën e madhe të çlirimit të Mekës!

Me “All-llahu ekber”, muslimanët kanë çliruar zemrat e verbuara të njerëzimit! Me “All-llahu ekber”, muslimanët kanë hapur dyert e mbyllura! Me “All-llahu ekber”, kanë ndërtuar qytetërimi dhe kanë shëruar zemra! Për këtë, kemi nevojë të kthehemi nga “All-llahu ekber”, ta ndjejmë thellë në zemër thirrjen e Zotit, ta përqafojmë atë dhe të bëhemi përhapësit e saj, deri në frymën e fundit!

Të dashur besimtarë,

Sado që themi: “All-llahu ekber”, ka ende shpresë për njerëzimin! Sepse ne nuk jemi misionarë të kijametit!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

(Nga hytbeja e xhumasë, më 15 mars 2019, në xhaminë e “Dy Vajzave”)

“DUAJA NË JETËN E MUSLIMANIT”, LIGJËRATA ME VLERË NË XHAMINË E DUDASIT

Në vazhdim të ligjëratave që Myftinia Shkodër po zhvillon në xhami të ndryshme të qytetit, ditën e martë, më 5 mars 2019, në xhaminë e lagjes Dudas, u zhvillua aktiviteti me temë: “Lutja në jetën e muslimanit”.

Në këtë mbrëmje fetare me dobi për të pranishmit, ligjëroi imami i xhamisë “Ebu Bekër”, teologu Idmir Plaku, si dhe imami i xhamisë Dudas, teologu Adrian Uraj. Aktivitetin e përshëndeti edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.

Ligjëruesit vunë theksin tek rëndësia e madhe që ka duaia në jetën e muslimanit, si një derë mëshire e hapur nga Zoti i gjithësisë për krejt krijesat e Tij, pa ndërmjetësinë e askujt.

Ligjëruesit shpjeguan se përse lutja mbetet një cak i rëndësishëm për krejt besimtarët, si dhe një mundësi e mrekullueshme e afrimit të përhershëm



me Zotin e gjithësisë.

U theksua se lutjet e shpeshta janë bekim për jetën e njeriut, qetësi shpirtërore dhe kënaqësi, që rrezaton në jetën e përditshme, në harmoninë familjare dhe marrëdhëniet me njerëzit mbarë.

Njëkohësisht u komentuan ajete që nxisin lutjen, si dhe u shpjeguan shkallët e etikës së lutjes, në marrëdhëniet e njeriut me Zotin e Tij.

Aktiviteti u mbyll me urimet e teologut Lavdrim Hamja dhe falënderimet e imamit H. Vehbi Dani.

MYFTIU TAKOI IMAMËT NË PRAG TË TRE MUAJVE TË MIRË

Paraditën e së enjtes, më 7 mars 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me imamët e qytetit dhe të fshatit, ku në vëmendje ishte hyrja e Tre Muajve të Mirë dhe përgatitja për pritjen e Muajit Ramazan.



Paraditën e së hënës, më 11 mars 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt z. Irfan Kaca, Kryeimam i Bashkësisë Islame në Ostros (zona e Krajës), Mali i Zi.

Gjatë takimit vëllazëror, Myftiu u interesua për bashkësinë e muslimanëve shqiptarë në zonën e Krajës, ku mësoi nga Kryeimami i Ostrosit për organizimin dhe aktivitetin e shqiptarëve në këtë trevë.

Njëkohësisht u diskutuan rrugët e bashkëpunimit me qëllim forcimin e lidhjeve të ndërsjellta, si dhe domosdoshmërinë e rritjes së kontributeve për të ruajtur traditat shekullore islame dhe kombëtare në zonën e Krajës.

MYFTIU PRITI KRYEIMAMIN E B.ISLAME NË OSTROS



Në këtë takim, Kryeimami i Ostrosit shoqërohej edhe nga z. Smajl Muja, sekretar i Bashkësisë Islame në Ostros,

si dhe nga z. Senad Maku, drejtues i Institutit për Drejtësi, Edukim dhe Arsim (IDEA) në Ulqin.

Ditën e martë, më 12 mars 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, së bashku me një grup imamësh të Myftinisë Shkodër, përcolli urimet protokollare për kryetarin e ri të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu.

Gjatë takimit, u theksua vlera e institucionit të KMSH-së si dhe angazhimi maksimal për të shërbyer me sinqeritet për të mirën e Thirrjes Islame dhe përhapjes së saj në çdo cep të vendit dhe përtej tij.

Në urimin e tij, Myftiu vuri theksin te domosdoshmëria e bashkëpunimit të elementit musliman shqiptar për të ruajtur amanetin e Thirrjes dhe për të shërbyer me përkushtim për përhapjen e vlerave të fesë islame, përtej axhendave të huaja, që punojnë ditë-natë, me të gjitha format, kundër Islamit dhe muslimanëve.

MYFTINIA SHKODËR URON KRYETARIN E RI TË KMSH



LIGJËRATA ME DOBI MBI KUPTIMET DHE DOBITË E MUAJVE TË SHENJTË

Ditën e enjte, më 14 mars 2019, pas namazit të akshamit në xhaminë e Parrucës, Myftinia Shkodër organizoi një tribunë fetare me temë: “Kuptimi dhe dobitë e Muajve të Shenjtë”.

Në fjalën hapëse, teologu Arben Halluni theksoi se ky aktivitet vjen me rastin e fillimit të Tre Muajve të Mirë, ku gjendet edhe muaji Rexheb, prej katër muajve të shenjtë të përmendur në Kur'an.

Ndërkohë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, tërhoqi vëmendjen e të pranishmëve se, përkujtimi i këtyre muajve duhet të na shërbejë për të kontrolluar cilësinë e marrëdhënies me Zotin dhe fenë e Tij në jetën e përditshme. Ai vuri theksin te rregullimi i veprave dhe dëshmimi i Islamit me



punë konkrete, larg fjalëve të shumta, deri në frymën e fundit.

Ligjëruan teologët e nderuar Adem Pizga, imam i xhamisë së lagjes Perash

dhe Naim Drijaj, imam i xhamisë së lagjes Parrucë.

Në ligjëratat e tyre, imamët e nderuar hodhën dritë mbi komentin dhe domethënien e Muajve të Shenjtë, si dhe data të shënuara në këto muaj.

U shpjegua me imtësi domethënia e secilit prej muajve në fjalë, vlera e adhurimeve dhe lutjes në to, marrëdhënia e të Dërguarit të Allahut (a.s.), sahabëve dhe dijetarëve të shquar të ymetit me këto muaj, si dhe domosdoshmëria e shfrytëzimit të tyre për të rregulluar sjelljen dhe veprat, gjithnjë në rritje drejt përkushtimit.

Aktivitetin e ëmbëlsoi me këndimin e ilahive, teologu Vullnet Pishtari, i pranishëm në këtë mbrëmje me vlerë.



Paraditën e të shtunës, më 16 mars 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, Drejtorin për Ballkanin e “Komisionit për Evropën dhe dy Amerikat”, në Kuvajt, z. Mahmud En-Nexhdi, që shoqërohej edhe nga donatori për projektin e ri të Kompleksit Islam në lagjen Kiras, z. Khalid A. Rebia, si dhe nga ndërmjetësuesi për zhvillimin e këtij projekti me dobi, z. Samed Shehu, drejtor i Fondacionit “Mirënjohja”.

Fillimisht, Myftiu shprehu falënderimet e tij për miqtë nga Kuvajti, duke theksuar se donatorët e shumë nga ky vend mik, kanë dëshmuar ndër kohëra bujarinë e madhe dhe shpirtin e bamirësisë, me të cilin karakterizohet populli i Kuvajtit, bamirësitë e të cilit mbeten gjurmë krenarie për ta, në çdo cep të botës.

Myftiu diskutoi edhe rreth projektit për fillimin e Kompleksit Islam në lagjen Kiras, ku theksoi se nevoja e besimtarëve dhe qytetarëve muslimanë për të është e madhe.

MYFTIU PRITI NJË DELEGACION NG KUAJTI



Myftiu falënderoi edhe angazhimin e z. Samed Shehu për koordinimin, sikurse shprehu mirënjohjen e Myftinisë Shkodër për z. Rebia, prania e të cilit i jep një kuptim të veçantë kësaj vizite.

Pas vizitës në Myftini, u zhvillua edhe

një inspektim të xhamia aktuale e lagjes Kiras, ku u ra dakort për nisjen sa më parë të punimeve për Kompleksin e ri, i cili do të plotësojë edhe shumë mangësi në zhvillimin e aktivitetit fetar e kulturor në këtë lagje.

NJË MBRËMJE E BEGATË FETARE NË XHAMINË E ZUESIT



Në kuadrin e ligjëratave, që i paraprijnë Muajit Ramazan 1440, ditën e shtunë, më 16 mars 2019, Myftinia Shkodër organizoi një tribunë fetare në xhaminë e fshatit Zues.

Tema e këtij tubimi me vlerë ishte: “Mirësjellja në jetën e muslimanit”, ku ligjëroi Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, si dje teologët e nderuar, Ervil Kuçi, imam i xhamisë Dërgut dhe Besim Barbullushi, i sapodiplomuar në studimet islame nga Universiteti Islam i Bursës.

Në ligjëratat me dobi u vu theksi tek morali dhe mirësjellja në jetën e muslimanit, bazuar në shembullin e Resulull-llahut (a.s.), të cilin e lartësoi Zoti i gjithësisë mbi krejt krijesat e Tij.

Ligjëruesit tërhoqën vëmendjen se,

muslimani spikat në shoqëri me veprat e tij, që përkthejnë më së miri moralin dhe me sjelljen e besimit të tij, që është esenca e krejt jetës.

U vu theksi te domosdoshmëria e kuptimit se, përtej namazit që falim në xhami, ajo që na vlen në jetën e përditshme është mirësjellja me familjen dhe komshinjtë, me tjetrin, kushdo qoftë ai dhe përhapja e frymës së besimit me krejt detajet e tij në shoqëritë njerëzore, si dëshmi e dashamirësisë tonë ndaj tyre.

Ligjëruesit sollën shembuj të shumtë nga fjalët dhe shembulli i Resulull-llahut (a.s.), si dhe ngjarje nga jeta e përditshme, që vërtetojnë se morali islam është garanci për një jetë në paqe me Zotin, me veten dhe me tjetrin.

NË RRUGË TË MBARË MINAREJA E RE E XHAMISË MILAN-RRASEK

Pasdreknë e së xhumasë, më 29 mars 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një inspektim, për të parë nga afër punimet që po bëhen për ndërtimin e minares së re në Milan-Rrasek të Postribës.

Minareja e re dhe sistemimi i oborrit të kësaj xhamie, pritet t'i japë edhe më gjallëri kësaj qendre, që frekuentohet rregullisht nga besimtarët e lagjes dhe kalimtarët e ndryshëm.

Myftiu vlerësoi angazhimin e besimtarëve, që po punojnë dhe ndihmojnë vullnetarisht për ta kryer sa më mirë dhe në mënyrë që muaji Ramazan ta gjejë të plotësuar edhe xhaminë e Milan-Rrasekut.

Myftiu falënderoi z. Sait Milani dhe bashkëpunëtorët e tij, për angazhimin e madh dhe përkushtimin ndaj xhamisë dhe projektit të ri, që pritej prej kohësh prej të gjithë besimtarëve të Postribës dhe më tej.

Myftinia Shkodër falënderon përzemërsisht kontributet bamirëse të vëllezërve të shumtë, që asnjëherë s'janë kursyer për realizimin e projekteve të dobishme dhe në ndihmë të xhamisë dhe gjallërimit të saj!

NJË MBRËMJE PLOT DRITË DITURIE NË XHAMINË E FUSHË ÇELËS



Ditën e mërkurë, më 20 mars 2019, pas namazit të akshamit, Myftinia Shkodër organizoi në xhaminë “Ebu Bekër”, në Fushë Çelë, një tribunë fetare me temë: “Namazi dhe zekati, dy adhurime të pandara në Islam”.

Aktiviteti nisi me fjalën e Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili theksoi se, gjithsecili prej muslimanëve e ka për detyrë ta dëshmojë moralin e fesë së tij dhe të zbatojë adhurimet e ndryshme, për të cilat është urdhëruar, duke u munduar të vishet me moralin e tyre dhe të përhapë mirësinë që përfton prej tyre.

Myftiu bëri thirrje për tregtarët dhe biznesmenët muslimanë, që të ruajnë dhe të pastrojnë pasuritë dhe bizneset e tyre, duke ndarë zekatin, që në vetvete është

bekim nga Zoti për pasurinë, mbrojtje dhe siguri hyjnore për të dhe të zotin.

Aktiviteti vijoi me dy ligjëratat e dobishme nga imamët e nderuar Gilman Kazazi dhe Ruzhdi Plangaj.

Në vasët e tyre të mbushura me argumente dhe shembuj praktikë, teologët e nderuar sollën në vëmendje të besimtarëve ajkën e Kur'anit dhe haditheve të përzgjedhura, që bëjnë fjalë për madhësinë e namazit dhe zekatit, si dy adhurime të pandara, plot mirësi e begati për njeriun.

Imamët vunë theksin te domosdoshmëria e disiplinimit të njeriut në marrëdhënien e tij me namazin, por edhe me zekatin, që së bashku përbëjnë boshtin e jetës shpirtërore dhe asaj materiale, të udhëzuar sipas thirrjes së besimit.

Mbrëmjen e së shtunës, më 23 mars 2019, në një atmosferë të begatë islame, Myftinia Shkodër zhvilloi tribunën islame me temë: “Vëllazëria në Islam”, ku ligjëroi Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari dhe imami i xhamisë së Dërgutit, teologu Ervil Kuçi.

Tematika e vëllazërisë islame na përfshin të gjithëve dhe mbetet një ndër stacionet më të rëndësishme, ku duhet të përqendrohet vëmendja e krejt muslimanëve në mbarë botën, tha në hyrje të aktivitetit teologu Lavdrim Hamja.

Ai falënderoi imamin e xhamisë, të nderuarin Nebi Alija, si dhe të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë mbrëmje të begatë në xhaminë e Velinajve.

Në ligjëratat e tyre, Myftiu dhe imami i xhamisë së Dërgutit, hodhën dritë mbi bekimin e madh me të cilin Zoti i gjithësisë ka rrethuar jetën e muslimanëve deri në

LIGJËRATA MBI VËLLAZËRINË ISLAME NË XHAMINË E FSHATIT VELINAJ



kijamet, vëllazërinë islame.

Ata theksuan se në tekstet kur'anore dhe në hadithet e shumta, tërhiqet vëmendja e muslimanit për të dashur për vëllanë e tij atë që do për vete, për të mos i bërë padrejtësi muslimanit, për të mos

HAXHI LIKA (TIRANË):

Me babanë kam pasur një lidhje të ngushtë. Nuk e di, por sot e kam kujtuar më me nostalgji se herët e tjera. Arsyeja është kjo.

Disa muaj pas hapjes së xhamisë së Et'hem Beut në vitin 1991, i them babës: Romo, kështu më pëlqente ta thërrisja kur kisha ndonjë kërkesë, dua të shkoj në xhami, a do më shoqërosh? Im atë, pasi u mendua pak, m'u drejtua me këto fjalë: Biri im, xhamia është vend i shenjtë, ata që shkojnë aty janë njerëz të mirë e të kulluar. A mund të bëhesh si ata? Nëse jo, më thuaj, se shkuarja në xhami nuk është si ndjekja e një kursi për ndonjë vegël muzikore, apo...

Nuk e kisha parë veten aq ngushtë. Pa u menduar shumë, ia ktheva: Romo, dua të shkoj në xhami. Normalisht në xhami shkova, por këtë ndodhi dhe fjalët-argument të tim eti m'u skalitën në kujtesë.

Në një rast tjetër i them: Plako, shokët e mi, krahas xhamisë kanë filluar të frekuentojnë edhe vende të tjera të mira. Nuk di si t'ia bëj? Kam rënë ngushtë. Ai më tha qetë-qetë, aq sa mund t'ia numëroje fjalët që nxirrte nga goja: Mos iu ndaj burimit, bir. Unë aty të çova, prandaj aty qëndro.

Nuk e di pse m'u kujtuan këto fjalë sot, gjithsesi kuptoj se ai më ka udhëzuar drejt. Ndoshta nuk jam bërë ai myslimani i kulluar, siç pretendonte im atë, por kam ditur ta ruaj lidhjen time me xhaminë (burimin), besimtarët dhe njerëzit që më rrethojnë.

Zot, ki mëshirë për babain tim të shtrenjtë!

“PASHA KOHËN!”, LIGJËRATA ME DOBI NË XHAMINË E MEDRESESË

Ditën e mërkurë, më 27 mars 2019, në xhaminë e Medresesë u zhvillua tribuna fetare me temë: “Pasha kohën!”, ku u mbajtën ligjëratat dhe këshilla me dobi për besimtarët e pranishëm.

Aktiviteti, që vjen në kuadër të këshillave fetare dhe ligjëratave me rastin e Tre Muajve të Mirë, që ka ndërmarrë Myftinia Shkodër në xhami të ndryshme të qytetit dhe fshatit, u zhvillua pas namazit të akshamit.

Fillimisht, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, iu drejtua të pranishmëve me disa këshilla dhe udhëzime që lidhen me vlerën e kohës dhe shfrytëzimin e saj në mënyrë që muslimani të dëshmojë si njeri i qytetëruar dhe i ditur, ndërtues i vlerave dhe përhapës i sigurisë dhe paqes në shoqëri.

Ligjëratat me vlerë mbajtën edhe teologët e nderuar Adil Cukali, imam i



xhamisë së Medresesë dhe Ardit Hoxha, imam i xhamisë Shirokë, të cilët hodhën dritë mbi komentimin e ajeteve dhe haditheve që lidhen me nxitjen hyjnore për vlerësimin e kohës dhe shfrytëzimin e saj në jetën e përkohshme të kësaj bote.

Ligjëruesit e nderuar sollën shembuj të larmishëm nga hadithet e përzgjedhura dhe jeta e të parëve tanë, prej sahabëve, tabiinëve dhe imamëve të shquar të ymetit islam, në trajtimin e kohës dhe përfitim prej saj.

MYFTIU, VIZITË NË FONDACIONIN “MIRËNJOHJA”



Paraditën e së enjtes, më 28 mars 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë në Fondacionin “Mirënjohja”, Tiranë, ku u prit nga drejtori i tij, z. Samed Shehu.

Gjatë këtij takimi të përzemërt, Myftiu shprehu falënderimet e tij për bashkëpunimin me Fondacionin “Mirënjohja”, si dhe kontributet e hershme të këtij fondacioni bamirës në zonën e Shkodrës, ku gjatë këtyre viteve të rimëkëmbjes islame, janë ndërtuar xhami dhe janë siguruar mbi 400 jetimë.

Nga ana e tij, z. Samed Shehu e falënderoi Myftiun për vizitën e tij, sikurse shfaqti gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit në fusha të ndryshme.

Gjatë takimit u theksua domosdoshmëria e bashkëpunimit dhe gjetjes së rrugëve për vijimësinë e projekteve të dobishme, sidomos në Shkodër.

Me këtë rast, Myftiu e falënderoi z. Samed Shehu për angazhimin e tij për të arritur finalizimin e marrëveshjes për ndërtimin e një kompleksi të ri islam në qytetin e Shkodrës.

Myftiu la edhe një shënim në librin e përshtypjeve të Fondacionit “Mirënjohja”, ku vlerësoi punën dhe kontributet, si dhe shprehu lutjet e tij për mbarësi dhe suksese në vazhdimësi.

Në këtë vizitë, Myftiu shoqërohej nga teologu Lavdrim Hamja dhe menaxheri i pronave, z. Blendi Alushi.

LIGJËRATA ME VLERË MBI PASTËRTINË, NË XHAMINË E SHTOJIT TË RI

Ditën e shtunë, më 30 mars 2019, Myftinia Shkodër organizoi në xhaminë e fshatit Shtoj i Ri një mbledhje fetare me temë: “Pastërtia është gjysma e besimit”, ku ligjëruan teologët Ardit Hoxha, imam i xhamisë Shirokë dhe Durim Kasemi, imam i xhamisë Parrucë.

Ligjëruesit hodhën dritë mbi vlerën e pastërtisë në Islam, bazuar në ajetet dhe hadithet e shumta, që nxisin dëlirësinë e zemrës, pastërtinë e trupit e rrobës, ushqimit e pijes, zemrës e nijetit.



Imamët e nderuar dhanë këshilla të dobishme, që lidhen me ngritjen shpirtërore të besimtarëve dhe rritjen e tyre në raport me urdhëresat e shumta fetare, që janë shpallur për ta nxjerrë njeriun nga errësira e hutimit dhe mosbesimit, në dritën besimit dhe pastërtisë, për të jetuar me dinjitet dhe krenari.

MEJTEPI I IM... XHAMIA E FSHATIT MELGUSHË

PAK HISTORI:

- Xhamia Melgushë, ndodhet në njësinë administrative “Bushat”, zona Shkodër.

- Përbëhet prej 200 familje. Fiset më të njohura janë: Seferaj, Zhejani, Shegaj, Muriqi, etj.

- Pas rilejimit të besimit islam në vendin tonë, xhamia Melgushë ka qenë ndër të parat në Shkodër që është hapur, pikërisht në vitin 1992.

- Në këtë xhami, nga viti 1992 deri më sot, kanë shërbyer si imam dhe mësues të mejtepeve: Berhan Bilani, Naim Drijaj, hoxhallarë të ndryshëm nga shoqata turke “Sulejmanie”, Muhamed Ali, Tahir Seferi, Sabah Seferaj, Shpresa



Zhejani (mësuese), Leonard Terziu, Sejmir Sela dhe Ylber Dyli (imam aktual).

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar afërsisht kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në këtë xhami, në periudha të ndryshme nga viti 1992 -2019 është rreth 180 nxënës dhe nxënëse.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Në kuadrin e vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit, pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset-mejtepet e mësim-

besimit, drejtuesi i tij, teologu Arben Halluni zhvilloi më 27 mars 2019 një takim me nxënësit e kursit fetar në xhaminë e fshatit Melgushë.

Fillimisht, u mbajt një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që mbartin ato, pikërisht përcimi te brezi i ri i mësimeve të vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit.

Më pas, përgjegjësi i arsimit evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesi Sejmir Sela, i cili me përkushtim të vazhdueshëm mirëmban këto veprimtari mjaft të rëndësishme edukative dhe arsimore.





Dr. Salahuddin Ahmed Keftaro
(Damask, Siri)

**Mos lejo që mëngjesi
ta shohë fytyrën tënde
të vërenjtur!**

**Buzëqeshi, përtej dhimbjes
së të djeshmes..!**

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org